

## CURRICULUM VITAE

Dr. Edi Puka është diplomuar, në vitin 2003, në Fakultetin e Shkencave të Formimit pranë Universitetit të Barit, Itali.

Në vitin 2007, fiton gradën “Doktor” me dizertacionin me temë “Proçeset Edukative dhe Globalizimi në Shoqëritë në Tranzicion, rasti i Shqipërisë”, pranë Universitetit të Barit, Itali.

Në vitin 2006 emërohet Dekan i Fakultetit të Edukimit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Më pas ka punuar si lektor në Universitetin “Marin Barleti” dhe Universitetin European të Tiranës.

Ai është autor i disa publikimeve shkencore në fushën e edukimit si: “Politiche universitarie e sistema educativo nell'Albania contemporanea”; “Educazione degli adulti e dinamiche interculturali”; “The Expert in the Training Processes and the role in today’s european society”; “Dall’Educazione degli Adulti all’educazione permanente”; “I processi formativi nella odierna società europea” si dhe autor i disa teksteve shkollore.

Dr. Edi Puka ka kryer edhe disa specializime në fushën e edukimit dhe të mësimdhënies në Universitetin e Barit (Itali); Universitetin e Venecias (Itali); Universitetin e Macerates (Itali) si dhe në Universitetin e Antwerpit (Belgjikë).

Aktualisht është Dekan i Fakultetit të Edukimit në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.